A.TOMSONI DHE HISTORIA E [L]LIBRIT SHQIP

Ky vështrim dhe hulumtim në historinë e viteve 1860 deri 1894, që ishin vitet e shërbimit të Tomsonit, edhe ndër shqiptarët, përfshin më së pari **një vështrim vlerësues** që lidhet jo vetëm me historikun e përkthimit të Biblës - një histori e trajtuar si e veçuar dhe me interes periferik për kulturën dhe historinë shqiptare - por, më gjerë: kjo periudhë vitesh është e qenësishme për kontributin e vet në historinë e librit dhe të librave në kulturën shqiptare. Kjo fushë e historiografisë me interes gjithnjë në rritje dhe disiplinë shkencore gjithnjë e më shumë e pranishme në programet e ndryshme të studimit universitar në shkencat humane, pra historia e librit, nuk mund të mos i paraqesë me hollësi ngjarjet që ndodhën me librin dhe që rrodhën në të gjithë kulturën shqiptare gjatë kësaj periudhe. Por a është pasqyruar në përmbajtjen e kësaj fushe kjo hallkë e zinxhirit të historisë së librit në shqip? Si është përshkruar dhe regjistruar kjo periudhë historike dhe ndikimi i saj? A nyjëtohen veçoritë, meritat dhe të metat e këtij kontributi? A janë të regjistruara mjaftueshëm elementet e kësaj historie, si: libri, librat, tirazhi, gjeografia e shpërndarjes, cilësia e botimit, autori, prodhuesi, lloji i botimit, cilësia e botimit etj.? Këto pyetje kanë qenë edhe sinorët e hulumtimit tonë.

Një pjesë e rëndësishme e shkrimit të historisë së kulturës së një kombi është edhe historia e librit të tij, si pjesë e qenësishme jo vetëm e regjistrimit dhe e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, por deri edhe pjesë e rëndësishme e vetë identitetit kulturor kombëtar. Shkrimi i historisë së librit ndër shqiptarët është një faqe që ende sot mungon në historiografinë shqiptare për shkaqe të ndryshme. Në buzë të përpjekjeve për shkrimin e regjistrimin e kësaj historie, jo vetëm thirrje e kohës, por tashmë edhe detyrë shkencore, kontributi i Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja për librin shqip mendojmë se duhet të përbëjë një ndër pjesët më të qenësishme të kësaj historie. Të mos e dokumentosh këtë kontribut, do të thotë të krijosh një zbrazëti historiografike për gati një shekull ngjarjesh e faktesh shkencore. Veçanërisht periudha që përfshin kontributin e Aleksandër Tomsonit është faqja më e rëndësishme e kësaj historie, kur libri dhe historia e tij dolën nga periudha e errësirës, e ndërdymjes për ekzistencë, e primitivizmit, izolimit, dhe iu shfaqën hulumtimit historiografik e shkencor.

Elementet e historisë së librit duhet të përmbledhin të dhëna për bibliologjinë, që lidhen me disiplinat e librit: libri fetar, libri shkollor, libri letrar etj.; të dhëna për tregtinë e tij, përshkrimin bibliografik me të dhënat e periudhave të ndryshme; zhvillimin e shkrimit dhe të shtypit të librit në aspekte estetike dhe të teknikës, deri dhe te ndikimi i librit nga pikëpamja kulturore e më gjerë në

shoqërinë njerëzore. Duke përmbajtur këto të dhëna, nevoja për regjistrimin e historisë së librit shkon përtej këtij interesi: Historia e librit nuk është vetëm një histori për librin, por edhe një histori e shoqërisë, e kulturës, e gjuhës së saj, e botës mendore të saj në përgjithësi, apo edhe e ekonomisë së kësaj shoqërie në veçanti etj. Studiuesi me kontributin më të madh në këtë pjesë e lëmë të historiografisë shqiptare, prof. Xhevat Lloshi, shkruan në vitin 1994 për kontributin e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja: "*Duke hetuar atë që sot mund ta quanim tregu i librit, këta përfaqësues na kanë dokumentuar gjendjen e arsimit dhe të kulturës në Shqipëri, sferat e përdorimit të shqipes së shkruar dhe shkallën e lëvrimit të saj, madje edhe kanë shtruar problemet e shkrimit të shqipes dhe të arsimit shqiptar*"[1].

Vitet e shek.XIX për shqiptarët dhe historinë e tyre, ashtu si dhe për shumë kombe të tjera të Evropës, janë vite të një historie me ngjarje të shpejta e të stuhishme, ku në pak vite shqiptarët mundën të përvijojnë elementet e para të identitetit kulturor kombëtar, arritën t'i siguronin vetes një vend në faqen e historisë së Evropës nga pikëpamja kulturore dhe politike, spikatën më së fundi si një bashkësi e përveçme nga gjiri i stërmadh i popujve të Perandorisë Osmane. A.Stipçeviçi në historinë e vet të librit, duke përmbledhur rëndësinë që libri ka në jetën e kombeve, shkruan: "*Numri i gjuhëve, në të cilat shtypen librat, gazetat e revistat, shtohen me numrin e popujve të cilët gjatë shek.XX çlirohen nga zotërimi politik e kulturor i fuqive të mëdha koloniale. Me krijimin e shteteve kombëtare shumë popuj nisin të shtypin libra në gjuhët e tyre popullore. ... Konsiderohet gjithsesi me të drejtë se edhe vetë përdorimi i gjuhëve kombëtare në shkencë e kulturë është pjesë e procesit të çlirimit nga zotërimi i huaj dhe pjesë e luftës për afirmimin e identitetit kombëtar.*"[2]. Edhe vetë A.Tomsoni mendonte se shkrimi në gjuhën amtare do t'i bënte shqiptarët "*të gjykonin për vetveten,* [gjë që] *do të minonte pushtetin tiranik*[3]" të ushtruar nga strukturat politike e fetare në Shqipëri në atë kohë.

Këto vite të shek.XIX për historinë botërore të librit, në përgjithësi, dhe në historinë e librit shënuan një pikë kthese.

Në kohën kur A.Tomsoni filloi veprimtarinë e tij për botimin e shpërndarjen e Biblës te shqiptarët Evropa gjendej në kulmin e zhvillimit të teknikës tipografike: një periudhë e re kishte nisur pak më herët në historinë e tipografisë (me makinën e re tipografike të ndërtuar nga Fridrih Këningu më 1812 mund të shtypeshin rreth 1

---

[1] Xhevat Lloshi, "**Kristoforidhi përmes dokumentimit**", Bota Shqiptare, Tiranë, 2005, f.110.

[2] Aleksandër Stipçeviq, ***Histori e librit***, Botimet "TOENA", Tiranë, 2000, f. f.332

[3] Xh.Lloshi, vepër e cituar, f.286, Dok.61.

000 ekzemplarë në orë[4]) dhe për rrjedhojë libri kishte nisur të shtypej më shpejt, kushtonte më lirë dhe gjendej praktikisht në duart e kujtdo që ishte i interesuar. Aleksandër Stipçeviçi jep këto të dhëna për këtë periudhë të historisë botërore të librit: "*Para shekullit XIX rrallëherë i shtypnin librat në një tirazh më të madh se 2000 deri 3000 ekzemplarë. Në shekullin XIX situata ndryshon rrënjësisht. Nga një anë numri i lexuesve, rrjedhimisht numri i blerësve, shtohet me vrull, kurse, nga ana tjetër, përdorimi i makinave tipografike dhe i letrës më të lirë bënë të mundur shtypjen e librave me tirazhe shumë më të larta. Prandaj nuk janë të rralla rastet që disa libra shtypen në 50 deri 100 mijë, e disa madje edhe në më shumë ekzemplarë*.[5]"

Ishte koha e "*botimeve të lira uniforme*" të ***Universal Bibliothek***, botime të shkrimtarëve, poetëve, filozofëve më të njohur të botës, botime të cilat do të pushtojnë botën e qytetëruar të kohës dhe "*çdo titull ishte shtypur mesatarisht në më shumë se 34 000 ekzemplar*ë[6]", ishte koha kur jo më libri, por gazetat "*bëhen literatura më e lexuar, sepse vetëm me anë të gazetave fjala e shkruar do të arrijnë në çdo shtëpi*.[7]"

Por cili ishte realiteti i librit në shqip në këto kohë? Historiografia regjistron se janë të pakta librat mbi shqipen e shqiptarët dhe gati asfare nuk ekziston libri në shqip dhe për rrjedhojë dhe shkrimi shqip. Realiteti i atij që kërkonte të dinte për shqipen e shqiptarët përmbante (përmendim disa tituj kryesorë): Angelo Masci, *Discorso sull'origine, costumi e stato attuale della nazione albanese*, 1807; Giuseppe Crispi, *Memorie sulla lingua albanese,* 1831; *Memorie storiche di talune costumanze appartenenti alle colonie greco - albanesi di Sicilia*, 1835; Farlati e Coleti, *Iliricum Sacrum*, vëllimi VII (1817) dhe vëllimi VIII (1819), botime të cilat përshkruajnë Shqipërinë e asaj kohe; Ritter Xylander, *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren*, 1835; Joseph Muller, *Albanien, Rumelien und die Österreich*, 1844; Vincenzo Dorsa, *Su gli Albanesi*, 1847, për të mbërritur edhe tek Johann Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, 1854; etj.

Po në gjuhën shqipe në atë kohë? Si më sipër *gati asfare*, citojmë këtu përpjekjet për të sjellë ndikim të N.Veqilharxhit me *Evëtarin* e tij (të parin më 1825 e më pas më 1844 dhe 1845), teksti i dr. Meksit që qarkullonte në mënyrë sporadike që nga botimi i parë i Ungjillit sipas Mateut më 1824 dhe i gjithë Dhiatës së Re më 1827, nga ana tjetër e Adriatikut përpjekjet e romantikëve të brezit të De Radës me "Milosaat", libra që nuk mund të arrinin një masë të

[4] Stipçeviq, vepër e cituar, f.268.
[5] Po ai, f. 298
[6] Po ai, f.275.
[7] Po ai, f.285.

mjaftueshme lexuesish për të qenë ndikues dhe faktor në historinë e librit dhe kulturës. Gjithashtu duhen cituar edhe njëfarë tradite letrare me ndikim e frymëzim oriental e islamik, e krijuar nga bejtexhinjtë, që Kadare në sprovën e tij të kohëve të fundit për "**Identitetin evropian të shqiptarëve**" e quan si "*njëfarë brumi i përzier shqiptaro-turk, [që] u thye përfundimisht, si një sajesë prej qerpiçi prej murit hijerëndë e monumental, ndonëse të ftohtë, të traditës së letërsisë dygjuhëshe shqiptaro-latine... kur studiuesit e morën nëpër duar, e panë se përveç që ishte qesharake për nga niveli, ajo ishte thellësisht e pamoralshme*". Librat e shkrimtarëve të krishterë të Veriut ishin të largët në kohë dhe të paarritshëm për lexuesit, edhe pse Kristoforidhi kishte pasur mundësi të hetonte dy prej tyre në kohën kur mësonte Hahn-in[8].

Kur A.Tomsoni nisi shërbimin e vet shqipja nuk ishte një gjuhë e shkruar. Vetë Kristoforidhi shkruan te "**Shënime mbi Shqipërinë: Gjuha dhe përkthimi i Shkrimeve të Shenjta**" se: "*Shqipja është një gjuhë e folur dhe jo e shkruar. Njerëzit nuk kanë libra, as nuk e mendojnë që gjuha e tyre mund të shkruhet si e vendeve të tjera e të përdoret midis tyre dhe në shkollat e tyre*"[9], diku tjetër thoshte se "*përkthimi ynë... do të jetë i pari libër, i cili do të përdorë këtë arsim të veçantë të shumë mijëra të rinjve shqiptarë gegë*"[10]. Edhe A.Tomsoni e shpreh këtë realitet: "*U kthyem në jug dhe kaluam nëpër Raguzë ... dhe arritëm në Shqipëri, një vend në të cilin populli deri më sot shquhet për të mos ia pasur zili se nuk ka asnjë literaturë në gjuhën amtare. Me sa duket, kjo vjen nga rrethana që gjuha e tyre e lashtë nuk ka pasur rëndësi përtej kombësisë së tyre...*" (Dok.61, 1869, por dhe Dok.35, 1866).

Kur Tomsoni e mbylli këtë shërbim tashmë në gjuhën shqipe, kontributi i ShBBV-së dhe i Shoqërisë Angleze të Broshurave Fetare kishte sjellë ndër shqiptarët më shumë se 25 tituj botimesh, të botuar në një numër ekzemplarësh të zakonshëm për sasinë e të këtillëve gjetkë nëpër Evropë në raport me sasinë e grupit të lexuesve të cilëve u shkonte libri. Aleksandër Stipçeviç shkruan: "*Rrjedhojat që shkaktuan sasitë shumë të mëdha të librave të shtypur* [bëhet fjalë për historinë botërore të librit në shekujt XV dhe XVI, shënimi im, T.T.] *në sferën e shkencës dhe të kulturës ishin të shumëfishta dhe afatgjata dhe vështirë se mund të identifikohen e analizohen në të gjitha hollësitë. Mjafton të themi se libri i shtypur ndikoi esencialisht në*

---

[8] Dok.10, I.Lowndes për S.S.Bergne, Maltë 13 prill 1857. "*Ai* [konsulli austriak, Hahn-i, shënimi im, T.T.] *kishte dy libra në këtë gjuhë, të shtypur me shkronja latine, të cilët nuk e dija se ekzistonin*", shih edhe Dok. 44, Pjesë nga reportazhi i A.Thomsonit për udhëtimin nëpër Shqipëri më 1867, f.255 në Xh.Lloshi, vepër e cituar.

[9] Xh.Lloshi, vepër e cituar, Dok.2.

[10] Po ai, f.221.

përhapjen e shkrimit, veçanërisht në popullsinë e qyteteve, në afirmimin e gjuhës popullore si gjuhë të letërsisë e të shkencës.[11]" Studiuesi Xh.Lloshi do ta quajë këtë periudhë kohën kur u hodhën "*themelet mbi të cilat u ngrit kultura kombëtare shqiptare*"[12].

Kur Tomsoni i nisi shërbimin e vet te shqiptarët, e kuptoi se puna e tij lidhej më tepër se me sjelljen në shqip të Biblës. Ai e kishte kuptuar ndikimin e madh që do të sillte kjo përpjekje dhe rrjedhojat e gjithë kësaj në vetëdijen e kombit dhe jetën e mëtejme të tij. "*Nga kjo pikëpamje veprimtaria e Shoqërisë në Bosnjë, Shqipëri, ... dhe pjesë të tjera të këtij vendi ku nuk ka misionarë, ka vlerën më të lartë shpirtërore dhe arsimore dhe nuk ka dyshim se po hidhen themelet e një përparimi të lavdërueshëm në ditët e ardhme, veçse si të gjitha themelet e tjera, ai nuk shihet prej vëzhguesit të shkujdesur*" (Dok.61, 1869). Duket se zemra e tij u lidh në mënyrë të veçantë me këtë popull me një histori të vështirë ekzistence. Ai shprehet "*Jam shumë i interesuar për këtë popull*" (Dok.16, 1865), "*...unë jam shumë i etur t'u jap shqiptarëve gjithashtu* [përveç ungjijve dhe punëve, shënimi im, T.T.] *Psalmet dhe Gjenezën, me të dy alfabetet, grek e latin...*" (Dok.19, 1865), madje synimi i tij shkonte edhe përtej mundësive dhe realitetit "*Veç kësaj mbetet edhe gjithë Dhiata e Vjetër*" (Dok.21, 1865).

Ambicia dhe synimi tjetër i Tomsonit ishte jo vetëm zgjimi shpirtëror i shqiptarëve, por edhe arsimimi i tyre përmes librave në gjuhën amtare: "*Kam dy librashitës në Shkodër e Janinë, që punojnë mirë. Nga 1 janari janë shitur 36 libra shqip. Do të dëshiroja më shumë për shkollat shqipe, por mund t'ju ndihmoja vetëm si person privat*" (Dok.31, 1865)

Ndryshimet që rrodhën prej këtij kontributi të SHBBV-së në këto vite e veçanërisht të A.Tomsonit në kulturën shqiptare në përgjithësi dhe atë të librit në veçanti lidhen me: arritjen e librit te lexuesi i thjeshtë dhe në një numër të gjerë, vetëdijesimin kombëtar për nevojën e njësimit të alfabetit dhe përgatitjen e terrenit për domosdoshmërinë e alfabetit të përbashkët, përvijimin e shqipes së shkruar, përvijimin e regjistrave funksionalë të gjuhës së shkruar, shqipja e shkruar u bë një fakt shkencor i arritshëm për kërkuesin dhe gjuhëtarin e shek.XIX[13], përshfaqjen e normës objektive të shqipes (konsolidimin e inventarit të njësive gjuhësore të përbashkëta për një dialekt e për të dy), por edhe mundësimin e mësimit në gjuhën amtare në shkolla, përgatitjen e shpërndarjen e gjerë të tekstit mësimor të/në gjuhën amtare (abetaret, historia e Dhiatës së Vjetër, Katekizmat etj.); për herë të parë kërkesat e lexuesit ishin faktor në përgatitjen e

[11] A.Stipçeviq, vepër e cituar, f.242.
[12] Xh.Lloshi, vepër e cituar, f.11.
[13] Shih për më tepër po ai, f.90 dhe f.181.

botimeve të reja dhe për herë të parë lexuesi e kuptoi rëndësinë e nevojës për arsim e lexim në gjuhën amtare etj.

Me Tomsonin historia e librit në shqip hyri në një fazë tjetër, në fazën e saj moderne, kur libri iu afrua të gjithëve dhe kujtdo që ishte i interesuar. Jo vetëm kaq por ishte gjuha e të gjithëve, e pjesës më të madhe të shqiptarëve, që kishte formësuar gjuhën e tekstit biblik: pra libri po shkonte te të gjithë, sepse ishte gjuha e të gjithëve që kishte shkuar te libri. Për vetë natyrën e pritshmërisë së komunikimit të tekstit biblik dhe ambicies së Shoqërisë Biblike për të arritur sa më shumë lexues, kuptueshmëria gjuhësore dhe semantike e tekstit provohej dhe dëshmohej me receptimin pozitiv ose jo, në terma të shitjes së ekzemplarëve dhe ndikimit të tyre në kulturën e vendit, të librave të veçantë të Biblës (botimi i ungjijve të veçantë përpara botimit të plotë). Duke pasur këtë pritshmëri, përpjekjet e Tomsonit ishin jo vetëm për sjelljen në shqipe të sa më shumë librave të Biblës e deri në Biblën e plotë, por edhe sjelljen e tekstit në një gjuhë të përditësuar dhe në një sistem shkrimi të përditësuar pikërisht në kohën kur të krijoje një alfabet të ri ishte kuptuar si një detyrë kombëtare.

Tomsoni ishte jo vetëm dëshmitar, por edhe aktor i kësaj historie kur gjuha shqipe nga një gjuhë vetëm e folur, u bë edhe një gjuhë e shkruar, si të gjitha gjuhët e fqinjëve të afërt e të largët të kontinentit. Botimet dhe ribotimet e librave shtrëngoheshin jo vetëm nga kërkesa në rritje e shqiptarëve për librin shqip, por edhe se shqipja e shkruar po bënte përpara shpejt edhe botimet e SHBBV-së "*duke ndjekur zhvillimin e përpunimin e gjuhës, proces në të cilin edhe ato jepnin kontribut, u bënë gjithnjë edhe më të përsosura nga ana gjuhësore*"[14]. Merita pa diskutim i takon më së pari Tomsonit dhe kërkesave të tij të një niveli të lartë të punës në lidhje me përzgjedhjen e përkthyesit, dallimin e grupit të lexuesve, përzgjedhjen e redaktorëve, të vlerësuesve, të librit të Biblës për t'u provuar te lexuesi, të qenët gjithnjë i informuar për zhvillimet politike, kulturore e gjuhësore ndër shqiptarët, kontributi që jepte me njohuritë e tij si profesor i hebraishtes për përkthimin etj.

Kontributi konkret i Tomsonit në botimet shqip lidhet me[15]:
- Fillimin e përpjekjeve për botimin e Dhiatës së Re në dialektin gegë, pjesë nga e cila u botuan më **1866** Katër Ungjijtë dhe Punët e Apostujve;
- Ndihma për botimin e Abetares në gegërisht më **1866** (në 1000 ekzemplarë)

[14] Po ai, f.70. (Xhevat)
[15] Pasqyrë e përgatitur me të dhëna nga Xhevat Lloshi, vepër e cituar.

- Ndihma për botimin e Abetares (në 2 000 ekzemplarë) dhe Katekizmave në dialektin gegë (në 2 000 ekzemplarë) nga Shoqëria e Broshurave në vitin **1867**
- Psalmet në dialektin toskë në vitin **1868** dhe gegë (**1869**)
- Ndihma për botimin e abetares në toskërisht më **1868**
- Dhiata e Re e plotë gegërisht më **1869**
- Historia e Shenjtësë Shkronjë për dielmt, e cila ishte një përmbledhje e thjeshtuar e pjesëve nga Dhiata e Vjetër e hartuar nga A.Tomsoni më **1870** dhe në dialektin toskë më **1872**.
- Ribotimi i 4 ungjijve dhe i Punëve të Apostujve në vitin **1872**. Puna merr një hov shumë të madhe tirazhi i librave është 2 000 deri 3 000 ekzemplarë.
- Ribotimi i Dhiatës së Re në dialektin gegë më **1872**.
- Ribotimi i Psallterit në dialektin gegë më **1872**.
- Ndihma për botimin e abetares shqip-greqisht më **1872** dhe botimi po këtë vit i "Istoria e Shkronjësë Shenjtëruarë për djem" në dialektin toskë dhe "Katrë përgjëmime për çunat vogjilë"

Ndërkohë këtë vit A.Tomsoni nis punën për përkthimin e Dhiatës së Vjetër (nga Pentateuku dhe Fjalët e Urta) dhe propozon të përkthehet e plotë ajo në dialektin gegë.

- Botimi i Ungjillit sipas Mateut në vitin **1878**
- Botimi i ungjijve të Markut, Lukës, Joanit, Punët e Apostujve më **1879**, si dhe një përmbledhje e tyre
- Botimi i Të bërëtë e Të dalëtë në dialektin toskë në vitin **1880**
- Fillimi i punës për botimin e Nomi i dytë, i botuar në vitin **1882** (me një tirazh prej 1 500 ekzemplarësh)
- A.Tomsoni mundësoi botimin e Gramatikës së Gjuhës Shqipe Sipas Dialektit Toskë të hartuar nga K.Kristoforidhi, botuar më **1882**
- Botimi i Fjalët e Urta të Sollomonit (në 1500 ekzemplarë) dhe Isaia (në 1 000 ekzemplarë) në vitin **1884**. Ndërkohë gjatë këtij viti ai propozon të fillojë punën për përkthimin e Librit të Jobit, Ruthit, Esterit, Ezdras dhe Nehemisë. Ambicia e A.Tomsonit ishte të sillte sa më shpejt në shqip për herë të parë Biblën e plotë.
- Ribotimi i Të bërëtë, Të dalëtë, Nom'i i Dytë, Proverbat dhe Isaia më **1884**
- Ribotimi i Katër Katekizmat në gegërisht, më **1884**, nga Shoqëria Angleze e Broshurave.
- Ribotimi i Ungjillit sipas Mateut dhe sipas Lukës në dialektin toskë më **1886**
- Botohet Ungjilli sipas Mateut dhe Të bërëtë të transkriptuar me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit në vitin **1889**, me korrekturën (redaktimin) e Gjerasim Qiriazit.
- Bëhet përpjekjet për të botuar më 1893 Psalmet e redaktuara nga Gjerasim Qiriazi
- Më **1894** A.Tomsoni merr si ndihmës Athanas Sinën.

- Botohet më **1895** Psallteri me shkronja greke, ndërkohë mbetet i pabotuar ai i transkriptuar me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit, i korrektuar nga Gjerasim Qiriazi dhe shkruar nga Th.Sina.

Po japim edhe katalogun e librave në shitje në Shtëpinë e Biblës në vitin 1881 në Stamboll si të dhëna me interes bibliologjik.

Catalogue of Sacred Scriptures and Other Books on sale at the Bible House, Constantinople, 1881

Albanian Tosk
New Testament with Greek letters 8 piast.
Gospels & Acts w/ Gr ltrs 4 piast.
Single Gospel & Acts w/ Gr ltrs 1 piast.
Psalms 126 pages - 2 piast
Genesis & Exodus 2.20 piast.

Gheg
New Testament - 843 pages/5 piast
New Test. & Psalms 7 piast
Gospels & Acts 3 piast
Psalms 122 pages - 2 piast.

Albanian Books
Tosk, Greek Letters
Old Testament History (Illustrated) 143 pages - 3 piast.
Primer (Illustrated) (kjo është nga 1881. Shumë interesante që Shoqatën ka bërë ketë dhe mendoj që ishte nga paraja e Tomsonit por duhet të kërkoj me shumë.) 32 pages - 1 piast
Catechism (Illustrated) 32 pages - 20 piast.

Gheg, Roman Letters
Old Testament Illustrate 136 pgs. 3 piast.
Primer Illustrated 32 pgs. 1 piast.
Catechism Illustrated 32 pgs 1 piast

Catalogue and Price List of Publications of the MISSIONS OF THE AMERICAN BOARD at The Bible House, Constantinople, 1896
Old Test Hist - illustr. 144 f. 1 piast
Dasuri e Perendise 16 f., 10 piast.
Drita & Botese 16 f., 10 piast.
Besa 16 f., 10 piast.
C'este Faj? 16 f., 10 piast.
Permet e Fajit (the fruit of sin) 16 f., 10 p.
Serim i Fajit 16 f., 10 p.
Ata 5 baske. 96 f., 1.30 piast.

Gheg in Roman Letters - Të gjithë janë librat e bordit amerikan

Old Test History illust. 136 f. 1 p.

Albanian primer 16 mo (Illus) Abetar skip 32 f., 20 piast.

Catechisms for children 32 mo., illustr (Katekisma per Tsunat e Vögile) 32 f., 10 piast.

Ky kontribut kaq i madh jo vetëm në cilësi, por edhe në sasi (në numrin e titujve, por dhe të ekzemplarëve) pritej të shkaktonte me domosdo ndryshime deri edhe në nivel shoqëror, jo vetëm kulturor. A.Stipçeviçi shkruan se "*Nxitja që mori prodhimi i librave e i publikimeve periodike (pas lirisë së shtypit të shpallur prej Revolucionit Francez) me revolucionin teknologjik ishte pa dyshim po aq vendimtare, sa edhe ai që sollën ndryshimet shoqërore*.[16]", duke nyjëtuar kështu pushtetin e madh që mbart përhapja e librit.

Përballë gjithë kësaj përpjekjeje madhore me ndikim mbarëkombëtar historiografia shqiptare hesht: dispensat universitare dhe manualet e Bibliotekës Kombëtare për historinë e librit shqip nuk përmbajnë asnjë rresht për këtë kontribut, historitë e letërsisë dhe të shkrimit shqip nuk shkojnë më tej përmendjes së ShBBV-së dhe sigurisht asfare të Tomsonit. Kontributi i Kristoforidhit shfaqet i copëtuar dhe i njëanshëm. Më fort se nxjerrja në dritë e fakteve (që më kohë janë zbuluar në numër të konsiderueshëm) koha **kërkon vlerësimin e tyre**, vendosjen e tyre në kontekstin e duhur dhe lidhjen e tyre me të tërën, të historisë së librit në veçanti dhe të trashëgimisë kulturore të shqiptares në përgjithësi. Vite më vonë, kur libri shqip e kishte vijuar udhën e historisë së vet me përpjekje të organizuara të vetë shqiptarëve, ende kontributi i SHBBV-së dhe i Tomsonit ishin faktor në kulturën shqiptare. Në 1917 Nahtigali shkruan në "Promemorje e gjuhës shqipe" se "*Kristoforidhi është njohësi më i mirë i gjuhës shqipe. Një gjë është e saktë që si elbasanishtja edhe emri i Kristoforidhit në popull është i rrethuar nga një aureolë e veçantë. Ungjilli i tij në shqip është libri më i përhapur*."

Nga gjithë faktet e dëshmuara historikisht për këtë periudhë, përfundimi i thjeshtë është se edhe një herë tjetër fati i gjuhës së shkruar dhe i librit te shqiptarët lidhet me Biblën dhe po aq me përhapjen e saj (madje libri i parë i shkruar me alfabetin e sotëm[17] të shqipes është Ungjilli sipas Markut më 1909). Ta ndash historinë e përkthimit të Shkrimit të Shenjtë nga historia e librit dhe e gjuhës së shkruar në shqip do të ishte një gabim shkencor, që do të cenonte vetë identitetin e kulturës shqiptare. E njëjta pasojë është edhe nëse e shpërfill këtë pjesë të historisë. Kështu historia e përkthimit të Biblës

[16] Stipçeviç f.284

[17] Xhevat, f.183.

nuk mund të jetë një degë e thjeshtë e shkrimit të historisë së librit në shqip.

Prof.Xhevat Lloshi shprehet se “*Ai që ndihmonte shqipen në shekullin e kaluar, të Rilindjes sonë, e kishte historikisht të fituar betejën*”. Nga faktet e qarta më ngjan se beteja për shqipen u fitua prej Atij që e ndihmoi atë.